



Gerti Sqapi

Lektor

**Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College**

Gerti Sqapi ka përfunduar studimet doktorale në Shkenca Politike në vitin 2016 dhe mban titullin shkencor Profesor i Asociuar që prej vitit 2023. Ai ka mbi 10 vite përvojë në mësimdhënie në nivel universitar dhe në kërkimin shkencor.

Gerti ka qenë fitues (si lider grupi) i dy projekteve kombëtare mbi baza konkurruese: njëri nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, titulluar “Bazat Sociale të Votës në Shqipëri: Ndikimet e Faktorëve Strukturorë Socialë dhe Frakturave Politike në Përcaktimin e Votës së Elektoratit Shqiptar”, si edhe projekti tjetër, i fituar nga Albanian-American Development Fund në kuadër të projektit READ, titulluar “Logjika e Funksionimit të Klientelizmit Politik në Optikën e Sjelljeve dhe Pritshmërive të Qytetarëve Shqiptarë: Një Eksplorim Etnografik i Shkëmbimeve Partikulariste midis Qytetarëve dhe Politikanëve (Ndërmjetësve) në Qarqet e Tiranës dhe Korçës”.

Gerti gjithashtu ka pasur përvoja afatshkurtra mësimdhënieje në kuadër të programit Erasmus+ në universitetet: Universiteti i Genovas (Itali), Universiteti i Roma Tre (Itali), Universiteti i Aveiro (Portugali), Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare të Romës (Itali), Universiteti i Valladolid (Spanjë), Universiteti i Évora (Portugali) dhe Universiteti i Uppsala (Suedi).

Gerti është pjesë e stafit akademik të TBU-së, duke mbajtur gjithashtu pozicionin e Drejtuesit të Qendrës për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike.